

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL/
CIVIL AVIATION AUTHORITY**

**AUTORITETI KOMBËTAR I
INVESTIGIMIT TË AKSIDENTEVE TË
SIGURISË SË OPERIMIT NË AVIACIONIN
CIVIL/
NATIONAL AUTHORITY FOR SAFETY
INVESTIGATION IN CIVIL AVIATION**

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI PËR IMPLEMENTIMIN EFEKTIV TË STANDARDEVE DHE PRAKTIKAVE TË REKOMANDUARA TË ICAO-S	MEMORANDUM OF UNDERSTANDING FOR THE EFFECTIVE IMPLEMENTA- TION OF ICAO STANDARDS AND REC- OMMENDED PRACTICES
<p>Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) dhe Autoriteti kombëtar i investigimit të aksidenteve të sigurisë së operimit në aviacionin civil (AKISA):</p> <p>Duke konsideruar se Shqipëria është anëtare e Organizatës Ndërkontinentale të Aviacionit Civil (ICAO) që nga viti 1990, me Dekretin e Presidentit Nr. 7438, datë 01.12.1990;</p> <p>Duke konsideruar se Shqipëria, nëpërmjet auditeve të ICAO USOAP, është subjekt i vlerësimit të nivelit të implementimit efektiv të standardeve dhe praktikave të rekomanduara të ICAO-s në sistemin e mbikëqyrjes në operim të saj;</p> <p>Duke pranuar se një nivel i lartë i implementimit efektiv është një tregues kyç i sistemit shtetëror të mbikëqyrjes së sigurisë në operim;</p> <p>Duke njojur rolin e rëndësishëm që kanë të gjithë entitetet rregullatorë dhe industria, duke përfshirë AAC dhe AKISA, në maturitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit të sigurisë në operim në Shqipëri; si dhe</p> <p>Duke konsideruar nevojën për bashkëpunim mes AAC-së dhe AKISA-s, veçanërisht në drejtim të</p>	<p>The Civil Aviation Authority (ACAA) and the National Authority for Safety Investigation in Civil Aviation (AKISA):</p> <p>Considering that Albania is a member of the International Civil Aviation Organization (ICAO) since 1990, with the Presidential Decree No. 7438, dated 01.12.1990;</p> <p>Considering that Albania, through the ICAO USOAP audits, is subject to the assessment of the level of effective implementation of ICAO's recommended standards and practices in the surveillance system in its operation;</p> <p>Acknowledging that a high level of effective implementation is a key indicator of the state system of safety oversight in operation;</p> <p>Recognizing the important role that all regulatory entities and industry, including ACAA and AKISA, have in the maturity and sustainability of the safety system in operation in Albania; as well as</p> <p>Considering the need for cooperation between ACAA and AKISA, especially in terms of ensur-</p>

<p>sigurimit të përditësimit të legjislacionit kombëtar me ndryshimet e anekseve të Konventës së Çikagos, reflektimit dhe zbatimit në kohën e duhur dhe publikimit të diferencave dhe diferencave thelbësore;</p> <p>Në përputhje me Konventën e Çikagos dhe Ligjin Nr. 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë",</p> <p>Dakordësojnë si më poshtë:</p> <p style="text-align: center;"><u>Neni 1</u> Përkufizime</p> <p>Për qëllim të këtij memorandumi, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e dhënë në këtë nen:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) "AAC" është Autoriteti i Aviacionit Civil, ent publik, jo buxhetor, në varësi të Ministrit. AAC-ja ushtron funksionet e autoritetit kombëtar për rregullimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha veprimitarive në fushën e transportit ajror, në përputhje me Kodin Ajror dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare; b) "AKISA" është Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve të Sigurisë së Operimit në Aviacionin Civil; c) "AIG" është fusha e investigimit të aksidenteve në programin USOAP; d) "AIP" është Publikimi i Informacionit Aeronautik (PIA), publikim që përbën informacion aeronautik të një natyre afatgjatë, thelbësor për lundrimin ajror, i nxjerrë në përputhje me rregulloren e miratuar nga Ministri; e) "CAP" është plani i masave korriguese; f) "EFOD" është një mjet për të asistuar Shtetet në vlerësimin e statusit të implementimit të Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara të ICAO-s (njohur shkurt si SARP) dhe identifikon diferençat që mund të ekzistojnë mes rregulloreve dhe praktikave kombëtare në krahasim me provizonet e përcaktuara në Anekset e Konventës; <p>g) "ICAO" është Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil;</p> <p>h) "ICAO state letter" është shkresa e</p>	<p>ing the updating of national legislation with the amendments of the annexes of the Chicago Convention, the reflection and implementation in due time and publication of essential differences and differences;</p> <p>In accordance with the Chicago Convention and Law No. 96/2020 "Air Code of the Republic of Albania",</p> <p>Agree as follows:</p> <p style="text-align: center;"><u>Article 1</u> Definitions</p> <p>For the purpose of this memorandum, the following terms shall have the meaning given in this article:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) "ACAA" is the Civil Aviation Authority, a public, non-budgetary entity, under the Minister in charge for Transport. ACAA exercises the functions of the national authority for the regulation and supervision of all activities in the field of air transport, in accordance with the Air Code and other legal acts and by-laws and in accordance with international obligations; b) "AKISA" is the National Authority for Safety Investigation in Civil Aviation c) "AIG" is the area of accident investigation in the USOAP program; d) "AIP" is the Aeronautical Information Publication (PIA), a publication containing aeronautical information of a long-term nature, essential for air navigation, issued in accordance with the regulation approved by the Minister; e) "CAP" is the corrective action plan; f) "EFOD" is a tool to assist the States in assessing the status of implementation of ICAO Standards and Recommended Practices (abbreviated as SARP) and identifies differences that may exist between national regulations and practices compared to established provisions in the Annexes of the Convention; <p>g) "ICAO" is the International Civil Aviation Organization;</p> <p>h) "ICAO state letter" is the letter sent by ICAO</p>
---	---

<p>dërguar nga ICAO drejtar Shtetit, e cila përban kërkesa ose informacione rreth masave të reja, që synojnë garantimin e operimeve të sigurta të aviacionit;</p> <p>i) Konventa e Çikagos është Konventa për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, e hapur për nënshkrim në Çikago, më 7 Dhjetor 1944, si dhe ndryshimet dhe shtojcat e saj të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;</p> <p>j) "NCMC" është Koordinatori Kombëtar i ICAO-s;</p> <p>k) "PQ"-të janë mjeti kryesor i përdorur në programin USOAP të ICAO-s për vlerësimin e implementimit efektiv të 8 Elementëve Kritikë (CE) të sistemit mbikëqyrës të sigurisë;</p> <p>l) "USOAP CMA" është aktivitet, në të cilin ICAO vlerëson implementimin efektiv të 8 Elementëve Kritikë të sistemit të mbikëqyrjes së sigurisë në operim dhe sistemit të investigimit të incidenteve dhe aksidenteve, përmes ndërmarrjes së një vlerësimi sistematik dhe objektiv të mbikëqyrjes së sistemit të Shtetit;</p> <p>m) "USOAP ICVM" është procesi i validimit, ku ICAO mbledh dhe vlerëson evidencat e mundësuara nga Shteti, për të demonstruar se Shteti ka implementuar masat korriguese (ose masat mitiguese/parandaluese, referuar significant safety concern SSCs), për të adresuar gjeljet e mëparshme.</p>	<p>to the State, which contains requests or information about new measures aimed at guaranteeing safe aviation operations;</p> <p>i) The Chicago Convention is the Convention on International Civil Aviation, opened for signature in Chicago on December 7, 1944, as well as its amendments and annexes ratified by the Republic of Albania;</p> <p>j) "NCMC" is the ICAO National Coordinator;</p> <p>k) "PQs" are the main tool used in the USOAP program of ICAO for evaluating the effective implementation of the 8 Critical Elements (CE) of the safety oversight system;</p> <p>l) "USOAP CMA" is an activity in which ICAO assesses the effective implementation of the 8 Critical Elements of the operational safety oversight system and the incident and accident investigation system, through undertaking a systematic and objective assessment of the State's system oversight;</p> <p>m) "USOAP ICVM" is the validation process, where ICAO collects and evaluates the evidence provided by the State, to demonstrate that the State has implemented corrective measures (or mitigating/preventive measures, referring to significant safety concern SSCs), to address previous findings.</p>
<p>Neni 2</p> <p>Koordinimi për pritjen e një misioni auditimi</p> <p>1. Në rastin kur njoftohet kryerja e një misioni auditues në kuadër te ICAO USOAP, që përfshin edhe fushën e AIG, pas njoftimit nga ICAO, NCMC merr masa që AAC të njoftojë zyrtarisht AKISA-n dhe do të caktojë një pikë kontakti për të lehtësuar komunikimin përkatës.</p> <p>2. AKISA, me marrjen e njoftimit nga AAC, do të marrë masa për angazhimin e personelit që do të ndërvaprojë me audituesit e ICAO-s dhe me pikën përkatëse të kontaktit, që do të caktohet në AAC. Gjithashtu, AKISA do të marrë masa për të pasur në dispozicion të gjitha evidencat e nevojitura, në formë elektronike dhe shkresore.</p>	<p>Article 2</p> <p>Coordination for hosting an audit mission</p> <p>1. In the event that an audit mission is announced within the ICAO USOAP, which also includes the field of AIG, after the notification by ICAO, the NCMC takes measures for the ACA to officially notify AKISA and will designate a point of contact to facilitate the relevant communication.</p> <p>2. AKISA, upon receiving the notification from the ACA, will take measures for the engagement of the personnel who will interact with the ICAO auditors and with the corresponding point of contact, which will be assigned to the ACA. Also, AKISA will take measures to have available all the necessary evidence, in electronic and written form.</p>

<p>3. AKISA do tē marrē masa pēr familjarizimin e pikës sē kontaktit tē caktuar prej saj, pēr pērdorimin e sistemit elektronik tē ICAO USOAP.</p> <p>4. Pika e kontaktit tē AKISA-s do tē komunikojë me NCMC nē AAC pēr çdo pēditësim që do tē bëjë nē sistem dhe pēr çdo asistencë që mund tē rezultojë e nevojshme.</p> <p>5. AAC do tē asistojë AKISA-n pēr familjarizimin me sistemin elektronik tē ICAO-s dhe do tē ndihmojë nē procesin e përgatitjes së AKISA-s pēr misionin auditues.</p>	<p>3. AKISA will take measures for the familiarization of the point of contact designated by it, for the use of the ICAO USOAP electronic system.</p> <p>4. AKISA's point of contact will communicate with the NCMC in ACAA for any updates to the system and for any assistance that may be required.</p> <p>5. ACAA will assist AKISA in familiarization with the ICAO electronic system and will facilitate in the process of preparing AKISA for the audit mission.</p>
<p>Neni 3</p> <p>Adresimi i gjetjeve nga AKISA</p> <p>1. Në përfundim tē një misioni auditues tē ICAO-s, me PQ me statusin "jo tē kënaqshëm" pēr sa i takon kategorisë AIG, AKISA do tē marrē masa pēr adresimin e gjetjeve nëpërmjet hartimit tē Planit të Masave Korriguese (CAP) pēr çdo PQ.</p> <p>2. Për një adresim adekuat, AKISA mund tē koordinojë paraprakisht çdo CAP me AAC-në, nëpërmjet pikave tē kontaktit tē paracaktura.</p> <p>3. Për CAP-et e pranuara nga ICAO, në çdo rast tē pēditësimi tē statusit tē adresimit tē tyre nga AKISA, kjo e fundit do tē koordinojë me NCMC-në nē AAC.</p> <p>4. AAC, brenda kapaciteteve tē saj administrative, do tē asistojë AKISA-n me ekspertizë sa here që tē nevojitet.</p> <p>5. Duke qenë se PQ-të e kategorisë LEG dhe ORG afektojnë njëkohësisht edhe AKISA-n, edhe AAC-në, pikat përkatëse tē kontaktit do tē komunikojnë reciprokisht te njëra-tjetra çdo CAP tē adresuar dhe evidencat përkatëse që afektojnë fushat respektive.</p>	<p>Article 3</p> <p>Addressing findings from AKISA</p> <p>1. At the conclusion of an ICAO audit mission, with PQs with "not satisfactory" status for the AIG category, AKISA will take measures to address the findings through the drafting of the Corrective Action Plan (CAP) for each PQ.</p> <p>2. For an adequate addressing, AKISA can coordinate each CAP in advance with the ACAA, through predetermined contact points.</p> <p>3. For CAPs accepted by ICAO, in any update of their addressing status by AKISA, the latter will coordinate with the NCMC in ACAA.</p> <p>4. ACAA, within its administrative capacities, will assist AKISA with expertise whenever needed.</p> <p>5. Given that the PQs of the LEG and ORG category simultaneously affect both AKISA and ACAA, the respective contact points will mutually communicate to each other each CAP addressed and the relevant evidence that affects the respective fields.</p>
<p>Neni 4</p> <p>Qarkullimi i ICAO State Letters</p> <p>1. "ICAO State Letters" mbërrijnë gjithmonë në</p>	<p>Article 4</p> <p>Circulation of ICAO State Letters</p> <p>1. "ICAO State Letters" always arrive at the</p>

adresë të AAC-së.	ACAA address.
<p>2. Çdo “State Letter” që ka të bëjë më një ndryshim në Aneksin 13 të Konventës së Çikagos si dhe çdo “State Letter” tjeter që ndikon në veprimtarinë e AKISA-s, do të kalojë nga NCMC për Shqipërinë, tek AKISA, në veçanti në pikën e kontaktit të caktuar prej kësaj të fundit për ICAO-n, brenda 7 ditëve nga mbërritja e saj në AAC.</p>	<p>2. Any “State Letter” affecting a change in Annex 13 of the Chicago Convention, as well as any other “State Letter” that affects the activity of AKISA, will pass from the NCMC for Albania, to AKISA, in particular to the point of the contact designated by the latter for ICAO, within 7 days of its arrival at ACAA.</p>
<p>3. AKISA do të rishikojë dhe vlerësojë “State Letter” për dakordësi ose kundërshti të standardit të ri apo të ndryshuar dhe, brenda 30 ditëve, do të përcjellë përgjigjen te NCMC.</p>	<p>3. AKISA will review and evaluate the “State Letter” for agreement or opposition to the new or amended standard and, within 30 days, will forward the response to the NCMC.</p>
<p>4. AAC do të adresojë qëndrimin e AKISA-s në përgjigjen që do të përcillet në ICAO.</p>	<p>4. ACAA will address AKISA's position in the response to be forwarded to ICAO.</p>
<p>Neni 5 Procesi i rregullbërjes për SARPs</p>	<p>Article 5 Rulemaking process for SARPs</p>
<p>1. AKISA do të iniciojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) përshtatjen në legjislacionin kombëtar të çdo standardi të njoftuar me ICAO “State Letter”, që kërkon ndryshime të legjislacionit kombëtar në lidhje me investigimin e aksidenteve dhe incidenteve të rënda në aviacionin civil dhe që është vlerësuar nga AKISA si i nevojshëm për t'u përfshirë në legjislacionin kombëtar; b) përshtatjen në legjislacionin kombëtar të çdo standardi në lidhje investigimin e aksidenteve dhe incidenteve të rënda në aviacionin civil, të marrë nga një Shtet tjeter. <p>2. Në funksion të rregullbërjes, AKISA do të hartojë një procedurë të brendshme, e cila do të sigurojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) afatet për kryerjen e hapave që do të garantojnë nxjerrjen e standardit në kohë; b) koordinimin dhe konsultimin me palët e interesuara; c) identifikimin dhe njoftimin e diferencave me standardin e ICAO-s; d) identifikimin dhe publikimin në AIP të diferencave thelbësore, shpjegimin e këtyre diferencave; e) koordinimi me AAC-në për publikimin e 	<p>1. AKISA will initiate:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) the adaptation into national legislation of any standard notified by ICAO “State Letter”, which requires changes to national legislation regarding the investigation of accidents and serious incidents in civil aviation and which has been assessed by AKISA as necessary to be included in national legislation; b) the adaptation into national legislation of any standards regarding the investigation of accidents and serious incidents in civil aviation, taken from another State. <p>2. In order to regulate, AKISA will draw up an internal procedure, which will ensure:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) the deadlines for performing the steps that will guarantee the issuance of the standard on time; b) coordination and consultation with interested parties; c) identification and notification of differences with the ICAO standard; d) identification and publication in AIP of essential differences, explanation of these differences; e) coordination with the ACAA for the publica-

<p>diferencave thelbësore.</p> <p>3. Për procesin e rregullbërjes, për përshtatjen në legjislacionin shqiptar të avionit civil të SARPs apo legjislacionit të një Shteti tjeter, AAC do të zbatojë rregullat e brendshme të Manualit për Menaxhimin e Anekseve të ICAO-s ACAA-DLS-IAMM.</p> <p>4. AAC do të ndihmojë AKISA-n në hartimin e procedurës së rregullbërjes, në harmoni me Manualin ACAA-DLS-IAMM.</p>	<p>publication of essential differences.</p> <p>3. For the rulemaking process, for the adaptation to the Albanian civil aviation legislation of the SARPs or the legislation of another State, ACAA will implement the internal rules of the Manual for the Management of ICAO Annexes ACAA-DLS-IAMM.</p> <p>4. ACAA will assist AKISA in drafting the rulemaking procedure, in accordance with the ACAA-DLS-IAMM Manual.</p>
<p>Neni 6</p> <p>Njoftimi i diferencave</p> <p>1. Pika e kontaktit, e caktuar në AKISA, do të kryejë identifikimin dhe publikimin e diferencave të legjislacionit kombëtar me Aneksin 13 të Konventës së Çikagos, në sistemin elektronik të ICAO-s:</p> <p>a) përpara datës në të cilën standardi i ICAO-s bëhet i aplikueshëm, të përcaktuar në "State Letter" përkatëse, dhe</p> <p>b) brenda 7 ditëve, nga hyrja në fuqi e standardit te ri në vendin tonë.</p> <p>2. Në rastin e identifikimi dhe publikimit të një diferenca thelbësore në EFOD të ICAO USOAP, AKISA do të kërkojë në AAC publikimin e saj edhe në AIP.</p> <p>3. Për publikimin e diferencave me SARPs, AAC zbaton Manualin për Menaxhimin e Anekseve të ICAO-s, ACAA-DLS-IAMM.</p> <p>4. AAC do të asistojë me ekspertizë AKISA-n gjatë procesit të identifikimit të diferencave, sa herë që të jetë e nevojshme.</p>	<p>Article 6</p> <p>Notification of differences</p> <p>1. The point of contact, designated in AKISA, will carry out the identification and publication of differences of national legislation with Annex 13 of the Chicago Convention, in the ICAO electronic system:</p> <p>a) before the date on which the ICAO standard becomes applicable, defined in the relevant "State Letter", and</p> <p>b) within 7 days, from the entry into force of the new standard in our country.</p> <p>2. In the case of identifying and publishing a substantial difference in the EFOD of ICAO USOAP, AKISA will ask the ACAA to publish it in the AIP as well.</p> <p>3. For publishing differences with SARPs, ACAA applies the ICAO Annexes Management Manual, ACAA-DLS-IAMM.</p> <p>4. ACAA will expertly assist AKISA during the process of identifying differences, whenever necessary.</p>
<p>Neni 7</p> <p>Pikat e Kontaktit</p> <p>1. Për zbatimin e këtij memorandumi, AKISA cakton pikë kontakti dhe e njofton në AAC.</p> <p>2. Për zbatimin e këtij memorandumi, AAC cakton pikë kontakti dhe e njofton në AKISA.</p>	<p>Article 7</p> <p>Points of Contact</p> <p>1. For the implementation of this memorandum, AKISA appoints a contact point and notifies it to ACAA.</p> <p>2. For the implementation of this memorandum, CAA appoints a contact point and notifies it to AKISA.</p>

<u>Neni 8</u> Rishikimi i memorandumit	<u>Article 8</u> Review of memorandum
Ky memorandum mund të rishikohet në çdo kohë, me një njoftim paraprak prej 3 muajsh nga palët.	This memorandum may be revised at any time, with a 3-month prior notice from the parties.

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
SHQIPTAR/
ALBANIAN CIVIL AVIATION
AUTHORITY**



**MAKSIM ET'HEMAJ
DREJTOR EKZEKUTIV/
EXECUTIVE DIRECTOR**

Data e nënshkrimit/
Date signed: 30.02.2024

**AUTORITETI KOMBËTAR I
INVESTIGIMIT TË AKSIDENTEVE TË
SIGURISË SË OPERIMIT NË AVIACIONIN
CIVIL/
NATIONAL AUTHORITY FOR SAFETY
INVESTIGATION IN CIVIL AVIATION**

Genc Resul-

**GENCI RESULI
DREJTOR EKZEKUTIV/
EXECUTIVE DIRECTOR**

Data e nënshkrimit/
Date signed: _____

